

ZHVILLIMI PROFESIONAL I DREJTORËVE TË SHKOLLAVE PËR NDËRTIMIN E NJË KULTURE SHKOLLORE GJITHËPËRFSHIRËSE

HARTA E POLITIKAVE

Maqedonia e Veriut



MACEDONIAN
CIVIC
EDUCATION
CENTER



ФОНДАЦИЈА ЗА ОБРАЗОВНИ И КУЛТУРНИ ИНИЦИЈАТИВИ
FOUNDATION FOR EDUCATION AND CULTURAL INITIATIVES
ЧЕКОР ПО ЧЕКОР • STEP BY STEP



Network of Education Policy Centers



**Empowering School Principals
for Inclusive School Culture
HEAD**

Ky publikim është një nga rezultatet e projektit HEAD: Përforcimi i drejtorëve të shkollave për një kulturë shkollore gjithëpërfshirëse që synon të trajtojë profesionalizimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të drejtorëve të shkollave në shkollat fillore dhe të mesme, duke u fokusuar në arsimin gjithëpërfshirës.



Network of Education Policy Centers

Koordinuar nga Rrjeti i Qendrave të Politikave Arsimore.



ФОНДАЦИЈА ЗА ОБРАЗОВНИ И КУЛТУРНИ ИНИЦИЈАТИВИ
FOUNDATION FOR EDUCATION AND CULTURAL INITIATIVES
ЧЕКОР ПО ЧЕКОР • STEP BY STEP

Partnerët e projektit në Republikën e Maqedonisë së Veriut:
Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore Hap pas Hapi



MACEDONIAN
CIVIC
EDUCATION
CENTER

Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar

Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Ky publikim është bashkë financuar nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



GOVERNMENT OF THE
REPUBLIC OF CROATIA
Office for Cooperation with NGOs

Bashkë financuar nga Zyra e Qeverisë për Bashkëpunim me OJQ-të. Përmbajtja e këtij dokumenti nuk pasqyron opinionin zyrtar të Zyrës. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura aty i takon tërësisht autorit/autorëve.

Impressum

Titulli

ZHVILLIMI PROFESIONAL I DREJTORËVE TË SHKOLLAVE PËR NDËRTIMIN
E NJË KULTURE SHKOLLORE GJITHËPËRFSHIRËSE – HARTA E POLITIKAVE
Maqedonia e Veriut

Botues

Rrjeti i Qendrave të Politikave Arsimore

Për botuesin

Lana Jurko

Autori

Ognen Spasovski

Përkthyes

Lulzim Ademi

Dizajni grafik

Viola Šebalj

2022.

HISTORIA

Sipas UNESCO-s (2005, 13–15), “Arsimi gjithëpërfshirës shihet si një proces në të cilin përcaktohet diversiteti i nevojave të të gjithë nxënësve dhe ato plotësohen përmes rritjes së pjesëmarrjes në të nxënit, kulturave dhe komuniteteve dhe me zvogëlimin e përjashtimit nga arsimi dhe nga procesi arsimor”. Vizioni i drejtorit për proceset arsimore në shkollë, qëllimet dhe praktikave udhëheqjes kanë një ndikim të rëndësishëm në atë se sa shkolla ka zhvilluar kulturë gjithëpërfshirëse dhe praktika. Roli i udhëheqjes së shkollës është vendimtar për ndërtimin e një kulture shkollore gjithëpërfshirëse, veçanërisht në aspektet vijuese:

- zhvillimi i të kuptuarit më të mirë të diversitetit dhe gjithëpërfshirjes,
- promovimin e praktikave pedagogjike gjithëpërfshirëse në kuadër të shkollës, dhe
- zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollës dhe komunitetit.

Duke qenë se krijimi i një kulture shkollore gjithëpërfshirëse është një proces kompleks që përfshin shumë faktorë, drejtorët e shkollave kanë nevojë për mbështetje cilësore dhe profesionale, që të mund t’i zhvillojnë kompetencat e nevojshme.

Praktikat arsimore gjithëpërfshirëse janë thelbësore për cilësinë e procesit së të nxënit, arritjet akademike dhe shëndetin mendor të fëmijëve/nxënësve. Duke pasur parasysh nevojën për përmirësimin e gjithëpërfshirjes nga aspekte të ndryshme në proceset arsimore në vendin tonë, si dhe rolin e rëndësishëm udhëheqës së drejtorit në procesin e ndryshimeve demokratike dhe progresive, lind nevoja për përmirësimin e zhvillimit profesional (ZHP) të drejtorëve, me qëllim që të pasurohen kompetencat e tyre për ndërtimin e një kulture shkollore gjithëpërfshirëse.

Çështja e kompetencave të cilat janë të nevojshme për vendin e punës drejtor i shkollës rregullohet me Ligjin për trajnimin dhe provimin për drejtorët e shkollave fillore, shkollave të mesme, konviktet e nxënësve dhe universitetin e hapur të punëtorëve për mësim të përjetshëm¹ nga viti 2015. Që nga viti 2016, trajnimi bazë realizohet nga një program i përbërë nga gjashtë module që kanë të bëjnë me: Aplikimi i teknologjisë informatike në menaxhimin e arsimit, Teoria e organizimit, Njerëzit në organizata, Drejtorët si drejtues pedagogjikë, Legjislacioni dhe Financat. Në provimi testohen aftësitë e kandidatit për të zbatuar njohuritë teorike në menaxhimin e një shkolle. Megjithatë, programi fokusohet më shumë në aspektet ligjore dhe administrative të punës së drejtorëve dhe nuk përfshin tema të tilla si aspektet e ndërtimit të një kulture shkollore gjithëpërfshirëse, diversitetit

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 10/15, 145/15, 192/15, 30/16, 120/18 dhe 140/18

dhe/ose drejtësinë sociale. Prandaj, nuk është e qartë tërësisht sa janë të vlefshme kompetencat e drejtorit të ardhshëm - për zhvillimin e suksesshëm të një kulture gjithëpërfshirëse në shkollë. Një problem shtesë për drejtorët është se ata kanë mundësi të kufizuara për trajnime të vazhdueshme në fushën e ndërtimit të një kulture gjithëpërfshirëse në shkolla.

Në kuadër të trajnimit dhe kompetencave të drejtorëve të shkollave, gjatë vitit 2020 është realizuar një studim² për nevojat e drejtorëve për zhvillim profesional në fushën e ndërtimit të një kulture shkollore gjithëpërfshirëse. Studimi është kryer në një mostër prej 187 drejtorëve të shkollave në tërë vendin (51% femra), ku 14% iu përgjigjën pyetësorit në gjuhën shqipe. 40% e drejtorëve ishin nga shkollat e mesme. Pjesëmarrësit kanë mesatarisht 21 vjet përvojë pune, nga të cilat 3.5 vjet mesatarisht në pozitë të drejtorit të shkollës. Shumica e shkollave (75%) kanë nga 101 deri në 1000 nxënës, deri në 75 mësues (78%) dhe deri në 5 anëtarë të personelit ndihmës (81%), asnjë nga këto shkolla nuk kishte asistent.

Sipas rezultateve të studimit, në kuadër të aktiviteteve të mëparshme të zhvillimit profesional të drejtorëve në fushën e ndërtimit të një kulture shkollore gjithëpërfshirëse, drejtorët mendonin se aktivitetet që ofronin mundësi për të praktikuar *idetë e reja* dhe ato që i mbindërtonin *njohuritë e tyre të mëparshme* kanë ndikimin më të madh pozitiv nga aspekti i punës së tyre si udhëheqës në shkolla. Ata gjithashtu theksuan se aktivitetet gjatë trajnimit *duhet të përshtaten me nevojat e tyre personale për zhvillimi* dhe të ofrojnë më shumë mundësi për *mësim aktiv*.

Fokusi i studimit ishte të përcaktohen nevojat e drejtorëve për zhvillim profesional në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me ndërtimin e një kulture shkollore gjithëpërfshirëse. Drejtorë që morën pjesë theksuan se zhvillim profesional u duhet më shumë në fushë të:

- mbështetja e përvojave të cilat e përfshijnë nxënësin në procesin e të nxënit,
- organizimin dhe koordinimin e mbështetjes për diversitetin në kuadër të shkollës,
- përgatitja e personelit të shkollës për t'u ballafaquar me diversitetin te nxënësit,
- mbështetja e bashkëpunimit ndërmjet mësimeve, nxënësve dhe personelit tjetër të shkollës dhe zbatimi i një plani zhvillues gjithëpërfshirës të shkollës,
- mbështetje gjatë ndërtimit e një mjedisi gjithëpërfshirës,
- rritja e ndërgjegjësimit të të punësuarit rreth qëndrimeve të tyre për diversitetin dhe gjithë përfshirjen.

2 Mlekuz, A., Veldin, M. (2020). *Principals' needs for professional development in the area of creating an inclusive school culture*. Ljubljana: Educational Research Institute. Studimi është realizuar në kuadër të projektit të realizuar nga NEPC-Zagreb dhe MCGO-Shkup në bashkëpunim me ERI-Ljubljana, e mbështetur me fonde të Komisionit Evropian.

Në bazë të rezultateve, u zhvillua një program për fuqizimin e kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për kulturat shkollore gjithëpërfshirëse (HEAD). U realizua një program pilot në Kroaci dhe Maqedoninë e Veriut, me pjesëmarrjen e 81 drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme, në temat e vijuese: qeverisja demokratike e shkollave, bashkëpunimi me të gjithë palët e interesuara, politikat gjithëpërfshirëse shkollore dhe ndërgjegjësimi për sfidat e shkollës ndaj gjithëpërfshirjes. Pas realizimit të programit pilot, u krye studimi për rëndësinë e trajnimit. Ajo tregon se zbatimi i programit të ZHP-së i hartuar posaçërisht në kuadër të projektit HEAD ka pasur një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e klimës/kulturës gjithëpërfshirëse si në shkollat fillore ashtu edhe në shkollat e mesme në vend. Rezultatet konfirmojnë nevojën dhe përfitimet e programit për përfortimin e kompetencave të drejtorëve të shkollave për ndërtimin e kulturave shkollore gjithëpërfshirëse.

Për më tepër, në maj 2022 u mbajt një Laborator i Politikave në Shkup, në të cilën mori pjesë një grup i palëve të interesuara (politikbërës, akademikë, OJQ dhe drejtorë të shkollave) me qëllim që të diskutohen ide për zhvillimin sistematik profesional të drejtorëve të shkollave për gjithëpërfshirje.

Gjetjet, opinionet, idetë dhe sugjerimet nga të gjitha këto aktivitete u përdorën si bazë për hartimin e këtij dokumenti i cili paraqet hartë të politikave.

QËLLIMI I POLITIKAVE

Qëllimi i politikave të këtij dokumenti është përmirësimi i sistemit aktual të zhvillimit profesional të drejtorëve të shkollave në mënyrë që të vendosen masa të avancuara sistemore për krijimin e një kulture gjithëpërfshirëse në shkolla.

Vizioni i politikave zhvilluese është të krijohen kushteve për arsim cilësor, në të cilat drejtorët e shkollave do të jenë udhëheqës të progresit drejt ndërtimit të një sistemi holistik të arsimit gjithëpërfshirës - ku çdo fëmijë dhe nxënës do të kenë mundësi të barabarta për të arritur potencialin e tyre të vërteta. Këtu, *arsimi cilësor për të gjithë* kuptohet si një e mirë publike dhe një vlerë themelore shoqërore. Në një sistem të tillë, një rrjet i drejtorëve kompetentë të shkollave, përmes proceseve pjesëmarrëse dhe bashkëpunuese, zhvillojnë programe dhe masa të përshtatshme për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tyre, i zbatojnë me sukses ato masa dhe vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme praktikat arsimore gjithëpërfshirëse, duke i përdorur metodat cilësore për mbledhjen e të dhënave për efektivitetin e masave. Në këto procese përdoret qasja nga poshtë-lart dhe nga lart-poshtë dhe të gjithë palët e interesuara bashkëpunojnë në mënyrë aktive. Të dhënat e mbledhura përdoren krijimin e masave kualitative të sigurisë, për përmirësimin e procesit mësimor dhe ndërtimit të një kulture shkollore gjithëpërfshirëse.

Implikimet e një vizioni të tillë nënkuptojnë se shoqëria do të ketë qytetarë me arsim cilësor, të cilët marrin pjesë aktivisht dhe me kompetencë në të gjitha zhvillimet dhe proceset shoqërore. Këta qytetarë do të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të ndërtuar mbi njohuritë. Drejtorët do të kishin një rol të rëndësishëm dhe aktiv në zhvillimin e qeverisjes demokratike të shkollave si qeliza themelore dhe thelbësore të shoqërisë, në promovimin e vlerave demokratike dhe ata do të jenë garant se praktikat demokratike janë përfshirë në dokumentet e politikave të shkollës. Udhëheqje e tillë e shkollave do të ishin në gjendje të ballafaqohet me sfidat e gjithëpërfshirjes jo vetëm në shkolla por edhe në komunitetin e gjerë.

HAPAT GJATË ZBATIMIT

Duke marrë parasysh rregulloret aktuale në rajon, e në bazë të informacioneve të mbledhura nga aktivitetet që më lartë u sqaruan, mund të propozohen hapat specifike vijuese për përforcimin e mëtejshëm të kompetencave të drejtorëve të shkollave për ndërtimin e një kulture gjithëpërfshirëse në shkolla.

1. Të përmirësohen rregulloret aktuale për ZHP të vazhdueshëm të drejtorëve në kontekst të arsimit cilësor gjithëpërfshirës për të gjithë dhe ndërtimit të një kulture gjithëpërfshirëse në shkolla. Gjithashtu është i nevojshëm harmonizimi i zgjidhjeve për financimin e ZHP të vazhdueshëm të drejtorëve, si dhe për udhëheqjen e procesit.

Gjithashtu, është e nevojshme të përmirësohen më tej rregulloret në mënyrë që gjithë përfshirja të mbulohet në mënyrë përkatëse nga vetëvlerësimi i shkollave, si dhe treguesit e gjithë përfshirjes të përfshihen në mënyrë përkatëse në vlerësimin integral të shkollave. E ndërlidhur me atë që u tha më lartë është nevojja e krijimit të proceseve të grumbullimit cilësor të të dhënave që kanë të bëjnë me gjithë përfshirjen në shkollë.

2. Përmirësimi i programeve për ZHP-në e drejtorëve në fushën e ndërtimit të një kulture gjithëpërfshirëse në shkolla. Për të qenë efektiv, ky proces duhet të jetë fleksibil dhe ta merr parasysh përvojën paraprake të punës së drejtorëve dhe duhet të bazohet në nevojat e tyre profesionale. Përmbajtja e këtij programi duhet të përfshijë dhe të theksojë strategji të ndryshme të krijimit të bashkëpunimit me palët e interesuara që kanë të bëjnë me shkollën, të përgatis kuadrin e shkollës për t'iu përgjigjur diversitetit të nxënësit, të mbështes pjesëmarrjen aktive të prindërve në jetën shkollore dhe të mbështesin përvojat e procesit gjithëpërfshirës në mësim. Programi duhet të përfshijë edhe tema të tjera që kanë të bëjnë me përforcimin e kompetencave të drejtorëve në fushat të: ndërtimit të një kulture shkollore gjithëpërfshirëse, udhëheqjes së shkollës dhe rolit personal dhe profesional në kontekstin e shkollës dhe planifikimit të udhëheqjes së shkollës dhe veprim drejt një kulture gjithëpërfshirëse shkollore.
3. Të mbështeten shkollat në procesin e zhvillimit të politikave shkollore për ndërtimin e një kulture shkollore demokratike dhe gjithëpërfshirëse. Dokumentet e politikave duhet të përfshijnë materiale rreth mënyrës se si ajo të sigurohet:
 - mbështetje për mësime të cilët praktikojnë mësimdhënie gjithëpërfshirëse,
 - mbështetje për nxënësit të cilët mësojnë në mjedisin plot me diversitet,

- zhvillimi i një atmosfere gjithëpërfshirëse në shkollë – mbështetje në shprehjen, vlerësimin dhe respektimin e diversitetit,
- zhvillimi i një mjedisi gjithëpërfshirës dhe të sigurt në shkollë.

Për të krijuar, për të zhvilluar dhe për të mbajtur një kulturë gjithëpërfshirëse në shkollë, shkolla ka nevojë që planet e saj zhvillimore dhe dokumentet e politikave të shkollës të bazohen dhe të ndërtohen mbi filozofinë gjithëpërfshirëse, në të cilën edhe planet dhe programet mësimore janë të përgatitur edhe zbatohen në mënyrë gjithëpërfshirëse.

4. Të mbështeten të punësuarit në shkollë që të zhvillojnë shkathtësi për mbledhje cilësore të të dhënave për gjendjen aktuale dhe ndryshimet në kontekstin e gjithë përfshirjes (zhvillimi dhe zbatimi i politikave shkollore gjithëpërfshirëse dhe sa gjithëpërfshirëse janë praktikatat e shkollës), si dhe të zhvillojnë masa përkatëse për promovimin, parandalimin dhe ndërhyrjen në fushën e gjithë përfshirjes – në bazë të të dhënave të mbledhura.
5. Të sigurohet mbështetje për të ndërtuar praktika dhe rrjete bashkëpunimi ndërmjet palëve të interesuara përkatëse që janë të rëndësishme për shkollën. Të punësuarit në shkollë, nxënësit, prindërit, komuna, institucionet qeveritare dhe OJQ-të duhet të kenë pjesëmarrje aktive në bashkëpunim në proceset vendimmarrëse në shkollë. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbështetjes së rrjeteve të drejtorëve të shkollave. Për më tepër, të gjitha palët e interesuara duhet të dinë se si t'i ballafaqohen me sfidat e përfshirjes në mënyrë individuale ose me bashkëpunim, si dhe të dinë për mundësitë dhe rastet që u ofrohen dhe kujt t'i drejtohen në mënyrë që të marrin ndihmë në organizimin dhe koordinimin e mbështetjes për diversitetin.

REKOMANDIME DHE HARTA E ZBATIMIT

Në bazë të gjetjeve dhe të dhënave të mbledhura përmes studimeve dhe procesit të konsultimit, i kemi formuluar rekomandimet vijuese, me hartë të zbatimit të hapave të parashikuar për përforcimin e kompetencave të drejtorëve në ndërtimin e një kulture gjithëpërfshirëse në shkolla.

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POLITIKAVE

TË PËRMIRËSOHET SISTEMI AKTUAL I ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË DREJTORËVE TË SHKOLLAVE, QË TË MUND TË VENDOSEN MASA TË AVANCUARA SISTEMATIKE PËR NDËRTIMIN E NJË KULTURE GJITHËPËRFSHIRËSE NË SHKOLLA.

Qëllime specifike

1. ZHVILLIMI RELEVANT PROFESIONAL I DREJTORËVE TË JETË I MUNDSHËM DHE I RREGULLUAR

Rekomandime

1.1. TË PËRMIRËSOHEN RREGULLORET QË KANË TË BËJNË ME PUNËN E DREJTORËVE TË SHKOLLAVE

1.1.1.

Të mbështetet organizimi i një konsultimi më të gjerë të aktorëve përkatës rreth sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të drejtorëve - në temat e mëposhtme:

- mundësitë për përmirësimin e programit të trajnimit për ZHP-në e drejtorëve në fushën e gjithë përfshirjes, me pjesëmarrjen aktive të drejtorëve në krijimin e tij.
- mundësitë për financimin e programeve të ZHP-së për drejtorët
- mundësitë për futjen e studimeve njëvjeçare për master ose studime specialistike për udhëheqje të shkollës
- mundësi për profesionalizimin e pozicionit të drejtor
- krijimi i një katalogu të kompetencave të nevojshme për pozicionin e drejtorit të shkollës
- përfshirja e kompetencave për udhëheqje arsimore në programet studimore të Fakulteteve Pedagogjike
- në vitin e tyre të parë pas emërimit
- mundësitë për vleftësimin e mësimi joformal dhe informal të kandidatit për drejtor në procesin e licencimit.

Kush me kë

Qendra Shtetërore e Provimeve (QSHP) së bashku me Shoqata e Drejtorëve të Shkollave (SHDSH) duhet të udhëheqin dhe në bashkëpunim me Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA), të iniciojnë konsultime më të gjera duke përfshirë të gjithë palët përkatëse relevante; Palët e tjera të interesuara të përfshira:

- Shoqatat e Mësimdhënësve (SHM)
- MASH-i
- Inspektorati Shtetëror Arsimor (ISHA)
- Qendra për Arsimimin e të Rriturve (QARR)
- Komunat
- Komuniteti akademik
- Organizatat që përgatisin trajnime

Niveli i zbatimit

Nacional

1.1.2.

Të diskutohet në nivel institucional se si të inkorporohen në mënyrë efektive treguesit për praktikat gjithëpërfshirëse në punën e udhëheqjes së shkollave/drejtorëve të shkollës - në procesin e vlerësimit integral të shkollave

Kush me kë

SHDSH duhet të iniciojë procesin; aktorë të tjerë të përfshirë:

- MASH-i
- ISHA
- SHM-ja
- MASH-i

Niveli i zbatimit

Nacional

1.2.

Rekomandime

TË SIGUROHET MBËSHTETJE INSTITUCIONALE PËR ZHVILLIMIN E PROGRAMIT TË ZHP-SË PËR PËRFORCIMIN E KOMPETENCAVE TË DREJTORËVE PËR NDËRTIMIN E NJË KULTURE GJITHËPËRFSHIRËSE NË SHKOLLA

1.2.1.

Të mbështeten institucionet dhe drejtorët në rishikimin e rregulloreve/direktivave për ZHP-në e drejtorëve me qëllim që të përforcohen kompetencat e tyre për ndërtimin e një kulture gjithëpërfshirëse në shkolla:

- të mbështetet Shoqata e Drejtorëve të Shkollave në zhvillimin e aktiviteteve të tyre për përmirësimin e ZHP dhe ndërtimit të një kulture shkollore gjithëpërfshirëse.
- të përcaktohet dhe futet një modul trajnimi i cili do t'i kushtohet ndërtimit të një kulture gjithëpërfshirëse në shkolla
- të harmonizohet trajnimin zyrtar për drejtorët me një program/modul të ZHP-së kushtuar një kulture gjithëpërfshirëse në shkolla (p.sh. Korniza e planit dhe programit mësimor: Fuqizimi i udhëheqjes së shkollës, për kulturën shkollore gjithëpërfshirëse NEPC 2022)

Kush me kë

SHDSH dhe Qendra Shtetërore e Provimeve (QSHP) me mbështetjen e MASH-it duhet të iniciojnë dhe drejtojnë procesin e përmirësimit të rregulloreve; Palët e tjera të përfshira:

- SHM-ja
- Inspektorati Shtetëror Arsikor (ISHA)
- Qendra për Arsimitin e të Rriturve (QARR)
- Komuna
- Komuniteti akademik
- Organizata që organizojnë trajnime

Niveli i zbatimit

Nacional

Rekomandime

1.3. TË PËRMIRËSOHET PROGRAMI EKZISTUES I TRAJNIMIT PËR DREJTORËT ME SYNIM QË TË PËRMIRËSOHEN KOMPETENCAT PËR ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS.

1.3.1.

Të ofrohen kushte më të gjera për zhvillimin e një programi për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të drejtorëve me qëllim të ndërtimit të një kulture gjithëpërfshirëse në shkolla.

- Programit duhet të sigurojë pjesëmarrjen aktive të drejtorëve të shkollave, mësimeve dhe nxënësve/prindërve.
- Programi duhet të bazohet në përvojën e punës së drejtorëve dhe mësimeve.

Kush me kë

SHDSH duhet të iniciojë dhe drejtojë procesin me mbështetjen e QSHP-së dhe MASH-it; Palët e tjera të interesuara të përfshira:

- SHM-ja
- Inspektorati Shtetëror Arsimit (ISHA)
- Komuniteti akademik
- Nxënës/prindër

Niveli i zbatimit

SHDSH, Nacional

1.3.2.

Programi i ZHP-së, duhet të mbështesë drejtorët në përforcimin e aftësive të tyre për të njohur diversitetin të nxënësve dhe nevojat e tyre që dalin nga ajo në procesin mësimor dhe në zhvillimin personal.

Kush me kë

SHDSH në bashkëpunim me rrjetet e tjera të drejtorëve duhet ta fillojnë dhe ta udhëheqin procesin, me mbështetjen e:

- SHM-së,
- Të punësuarit në shkollë,
- nxënësve/prindërit,
- Komuniteti akademik

Niveli i zbatimit

Shkollat

1.3.3.

Programi i ZHP-së, i ndihmon drejtorët në përforcimin e aftësive të tyre për të njohur aspektet e ndryshme që e bëjnë shkollën dhe procesin mësimor gjithëpërfshirës dhe të sigurt: përfshirjen e moduleve për mjedise gjithëpërfshirëse dhe fizikisht të sigurta, respektimin e diversitetit, parandalimin e dhunës së bashkëmoshatarëve etj.

Kush me kë

SHDSH ta fillojnë dhe ta udhëheqin të mbështetur nga: Komunitat, SHM-të, të punësuarit në shkollë, nxënësit/prindërit, Komuniteti akademik, ISHA

Niveli i zbatimit

Shkollat

1.3.4.

Programi i ZHP-së, i ndihmon drejtorët në përforcimin e kompetencave të tyre për menaxhimin e burimeve financiare dhe njerëzore që ta mbështesin gjithë përfshirjen.

Kush me kë

SHDSH ta fillojë dhe ta udhëheq procesin të mbështetur nga: QSHP, ISHA Komunitat

Niveli i zbatimit

Shkollat, Nacional

Qëllime specifike

2. PROMOVIMI I NJË KULTURE SHKOLLORE GJITHËPËRFSHIRËSE

Rekomandime

2.1. TË PROMOVOHET FILOZOFIA E GJITHË PËRFSHIRJES

2.1.1.

Të mbështeten shkollat dhe drejtorët që të zhvillojnë aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e gjithë përfshirjes në komunitetin shkollor; si dhe të përhapen vlerat e gjithëpërfshirjes, duke respektuar diversitetin, rëndësinë e mjediseve të sigurta dhe gjithëpërfshirëse (fizike dhe psikologjike).

Kush me kë

SHDSH duhet të iniciojë dhe drejtojë procesin e mbledhjes dhe ndarjes së praktikave të mira; Palët e tjera të interesuara të përfshira:

- SHM-ja
- Komuniteti akademik
- Nxënës/prindër
- Komunat

Niveli i zbatimit

Shkollat, Përfshirje rajonale

Rekomandime

2.2. TË MBËSHTETET NDËRTIMI I POLITIKAVE EFEKTIVE SHKOLLORE TË ARSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS

2.2.1.

Të mbështeten shkollat dhe drejtorët e shkollave të përpilojnë dokumente për politika të përshtatura sipas shkollës, të cilat do të përshkruajnë situatën aktuale në komunitetin e shkollës në lidhje me gjithë përfshirjen dhe do të jenë udhërrëfyes për përmirësimin e proceseve arsimore gjithëpërfshirëse në shkollat. gjatë përpilimit të këtyre dokumenteve duhet të përdoret qasje nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart.

Kush me kë

SHDSH dhe ISHA duhet të iniciojnë dhe udhëheqin procesin; Palët e tjera të interesuara të përfshira:

- SHM-ja
- Komuniteti akademik
- Nxënës/prindër
- MASH-i
- QSHP

Niveli i zbatimit

Shkollat; Përfshirje rajonale; Nacional

2.2.2.

Të mbështeten shkollat në përpilimin e një dokumenti strategjik për ndërtimin e mjediseve gjithëpërfshirëse dhe të sigurta - fizike dhe socio-emocionale.

Kush me kë

SHDSH dhe ISHA duhet të iniciojnë dhe udhëheqin procesin;

Palët e tjera të interesuara të përfshira:

- Mësimdhënësit
- Nxënës/prindër
- Komuniteti akademik

Niveli i zbatimit

Shkollat; Nacional

2.2.3.

Të mbështeten të gjithë mësimdhënësit dhe të punësuarit e shkollës të përpilojnë një plan vjetor të zhvillimit personal, i cili do të ketë një qasje gjithëpërfshirëse.

Kush me kë

SHM-ja dhe shoqatat për mbështetje të mësimdhënësve ta fillojnë procesin me mbështetjen e drejtorëve, nxënësve/prindërve, komunitetit akademik

Niveli i zbatimit

Shkollat; Nacional

2.2.4.

Të mbështeten shkollat – drejtorët dhe mësimdhënësit – të sigurojnë pjesëmarrje aktive të prindërve në procesin e ndërtimit të një jete shkollore gjithëpërfshirëse.

Kush me kë

Drejtorët e shkollave të iniciojnë procesin në bashkëpunim me mësimdhënësit dhe prindërit

Niveli i zbatimit

Shkollat

2.2.5.

Të përmirësohet procesi i vetëvlerësimit të shkollave në bazë të indeksit të gjithëpërfshirjes dhe indekseve të tjera të rëndësishme për gjithëpërfshirjen.

Kush me kë

Drejtorët e shkollave të iniciojnë procesin në bashkëpunim me ISHA-në, të mbështetur nga mësimdhënësit

Niveli i zbatimit

Shkollat

Rekomandime

2.3. TË MBËSHTETET ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE TË BASHKËPUNIMIT NË PROCESIN E NDËRTIMIT TË NJË KULTURE GJITHËPËRFSHIRËSE NË SHKOLLA

2.3.1.

Të zhvillohen procedura dhe praktika për bashkëpunimin e të gjithë palëve të interesuara në shkollë me qëllim të përmirësimit të kulturës gjithëpërfshirëse në shkollë.

Kush me kë

Drejtorët e shkollave të iniciojnë procesin në bashkëpunim me mësuesin, të punësuarit dhe prindërit

Niveli i zbatimit

Shkollat

2.3.2.

Të mbështeten shkollat gjatë ndërtimit të praktikave dhe masave bashkëpunuese për promovimin e praktikave gjithëpërfshirëse, për parandalimin e praktikave të këqija dhe për ndërhyrje në situata kur ka praktika të këqija.

Kush me kë

Drejtorët e shkollave dhe BZHA-ja të iniciojnë procesin në bashkëpunim me mësuesin, të punësuarit dhe prindërit

Niveli i zbatimit

Shkollat

2.3.3.

Të mbështeten shkollat që ta rishikojnë përbërjen, rolin dhe përgjegjësitë të ekipeve të shkollave për gjithë përfshirje. Aktualisht fokusi i tyre është te nxënësit me aftësi të kufizuara. Ekipeve shkollore për gjithë përfshirje duhet të riorganizohen në mënyrë që t'i mbulojnë nevojat e të gjithë nxënësve që kanë nevojë për mbështetje në procesin mësimor.

Kush me kë

Drejtorët e shkollave dhe BZHA-ja të iniciojnë procesin në bashkëpunim me:

- mësuesin e shkollave,
- SHM-në
- shërbimin profesional
- Qendra burimore
- prindërit

Niveli i zbatimit

Shkollat; Nacional

2.3.4.

Të mbështeten shkollat të përpilojnë procedura dhe praktika për pjesëmarrjen e fëmijëve/ nxënësve në ndërtimin e politikave dhe masave gjithëpërfshirëse në shkollë.

Kush me kë

Drejtorët e shkollave të iniciojnë procesin në bashkëpunim me mësimdhënësit, personelin dhe nxënësit

Niveli i zbatimit

Shkollat

2.3.5.

Të mbështeten shkollat të përpilojnë procedura dhe praktika shkollore për nxënësit, mësimdhënësit, drejtorët dhe prindërit se si të reagojnë dhe kujt t'i drejtohen nëse kanë nevojë, nëse ka dhunë nga ana e bashkëmoshatarëve ose disa praktika tjera të këqija.

Kush me kë

Drejtorët e shkollave të iniciojnë procesin në bashkëpunim me mësimdhënësit, personelin, prindërit dhe nxënësit

Niveli i zbatimit

Shkollat

2.3.6.

Të ndihmohen drejtorët gjatë formimit të rrjeteve për mbështetje të drejtorëve të shkollave.

Kush me kë

SHDSH-ja të iniciojë procesin në bashkëpunim me rrjetet e drejtorëve dhe komunat

Niveli i zbatimit

Shkollat; Përfshirja rajonale; Nacional

2.3.7.

Të ndihmohen shkollat dhe drejtorët të realizojnë një bashkëpunimi efektiv me komunat, institucionet shtetërore të arsimit dhe OJQ-të.

Kush me kë

SHDSH dhe komunat të fillojnë procesin në bashkëpunim me BZHA-në, MASH-in, OJQ-të

Niveli i zbatimit

Shkollat; Përfshirja rajonale; Nacional

Qëllime specifike

3. MONITORIMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË DREJTORËVE DHE I GJITHË PËRFSHIRJES NË SHKOLLA

Rekomandime

3.1. MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE EFEKTIVE TË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE QË JANË TË RËNDËSISHME PËR GJITHË PËRFSHIRJEN

3.1.1.

Të ndihmohen drejtorët dhe mësimdhënësit/ të punësuarit gjatë mbledhjes së të dhënave të rëndësishme për gjithë përfshirjen, dhe të zhvillohen më tej praktikatat dhe/ose të përshtaten praktikatat aktuale bazuar në provat e mbledhura, si dhe të bëhen ndërhyrje nëse është e nevojshme – në bazë të provave.

Kush me kë

SHDSH dhe ISHA të iniciojnë dhe udhëheqin procesin; Palët e tjera të interesuara të përfshira:

- SHM-ja
- Komuniteti akademik
- Nxënës/prindër

Niveli i zbatimit

Shkollat; Nacional

3.1.2.

Të mbështeten shkollat që të përmirësojnë procesin e vetëvlerësimit: si të mbledhin të dhëna që janë të rëndësishme për arsim cilësor gjithëpërfshirës dhe të dinë se si t'i përdorin të dhënat për përmirësimin e proceseve mësimore.


Kush me kë

SHDSH dhe ISHA të iniciojnë dhe udhëheqin procesin; Palët e tjera të interesuara të përfshira:

- ISHA-ja
- SHM-ja
- Komuniteti akademik
- Nxënës/prindër

Niveli i zbatimit

Shkollat; Nacional



Ky publikim është një nga rezultatet e projektit HEAD: Përforcimi i drejtorëve të shkollave për një kulturë shkollore gjithëpërfshirëse që synon të trajtojë profesionalizimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të drejtorëve të shkollave në shkollat fillore dhe të mesme, duke u fokusuar në arsimin gjithëpërfshirës.